



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 155/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Nisma Për Kosovën , dega në Prizren, për shkak të vendosjes së banerëve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, kështu që subjektit politik Nisma Për Kosovën , dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 900 (Nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014 LVV dega në Prizren ka parashtruar ankesë në PZAP me të cilën pretendon se me datën 03.06.2014 aktivistët e LVV-së në Prizren diku rreth orës 12:00 kanë vërejtur se në udhëkryqin që lidh rrugët Jeronim de Rada dhe Westley Clark në Prizren mbi rrugë publike ishte vendosur baneri i Albulena Balaj kandidate për deputete të Kuvendit të Kosovës nga NISMA PER KOSOVEN. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe Rregullave Zgjedhore. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik NISMA në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.06.2014, në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik NISMA në të cilën deklaroi se baneri i kandidatit në fjalë është hequr nga vendi ku kanë qenë i vendosur dhe se brenda afatit të paraparë është përmirësuar shkelja dhe si dëshmi ka bashkangjitur fotografit nga vendi i ngjarjes duke e larguar banerin nga vendi ku kanë qenë i vendosur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik NISMA Albulena Balaj ishte vendosur mbi rrugët publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik NISMA është shkelur neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit të saj është vendosur mbi rruge publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik NISMA që ka ndërrmar për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 155/2014 më datën 06.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*